



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Nr. 12/1

Tiranë më 27.05.2009

L I C E N C Ë
Nr. 12 datë 15.03.1999

PËR TË VEPRUAR SI BANKË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 7, 10 dhe 11 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të nenit 3, pika 4 shkronja "c", nenit 12 dhe nenit 43 shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", vendimit nr.22, datë 03.03.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, "BANKËS PROCREDIT" sh.a. me drejtori qendrore në Tiranë (ish Banka Fefad sh.a.), ndryshuar emri nëpërmjet aktit zyrtar nr. 2516/1, datë 08.09.2003 të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, i jepet licenca për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë.

Licenca i lejon "BANKËS PROCREDIT" sh.a. të kryejë veprimtaritë e përshkuara në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme ose e tjetërsueshme.

Ardian FULLANI
GUVERNATOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Tiranë më 27.04.2015

ANEKS

LICENCA NR. 12/1

VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR BANKËN PROCREDIT SH.A.

Banka Procredit sh.a., në bazë të nenit 134, pika 1 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 06, datë 11.02.2009 "Për përshtatjen e dokumentacionit mbi të cilin mbështetet veprimtaria bankare dhe financiare e bankave, që operojnë në Republikën e Shqipërisë me kërkesat e ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", dhe të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 68, datë 18.12.2014 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka ProCredit sh.a.", është e licencuar të kryejë veprimtaritë bankare, sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit të lartpërmendur dhe veprimtaritë financiare si më poshtë:

- 1) Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekore.
- 2) Qiranë financiare.
- 3) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave.
- 4) Ofrimin e garancive.
- 5) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutë, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
 - i) instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, certifikata të depozitave etj.),
 - ii) këmbim valutë,
 - iii) instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje *swap* dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen.
- 6) Ofrimin e shërbimit të kasave të sigurimit.
- 7) Emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit dhe çeqet bankare, kartat e

pagesës dhe pagesat me celular) etj., përfshirë emetimin e parasë elektronike.

- 8) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara në pikat 2 deri 7 si më sipër.
- 9) Tregtimin për llogari të saj, qoftë dhe në një këmbim valutë, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, të letrave me vlerë të transferueshme.

Gent SEJKO

GUVERNATOR

